

"PRISHTINA ENERGJETIKE"



Projekti "Llapit 1"

"Llapit 1" është projekt në kuadër të megaprojektit investiv në rajonin e Prishtinës. Plani investues i KEDS-it në Prishtinë përfshin rritjen e kapaciteteve të linjave ekzistuese nga 10 kV në 20 kV, krijimin e linjave alternative, futjen nën tokë të 90% të rrjetit të tensionit të mesëm, zëvendësimin e 50% të linjave të tensionit të ulët. Nga këto investime do të përfitojnë direkt 90 mijë konsumatorë.

Të dhëna specifike për projektin: Demolimi i 53 shtyllave, vendosja e 1.1 km kabllave të reja të tensionit të mesëm, dhe 15.8 km kabllave të reja të tensionit të ulët, si dhe hapja e kanaleve.

Përfitues nga projekti "Llapit 1" - 449 konsumatorë

Lokacionet kryesore ku do të punohet: Rr. Esad Mekuli, Rr. Hoxhë Kadri Prishtina, Rr. Lidhja e Prizrenit dhe Rr. Llapi.

Periudha e zhvillimit të projektit: 2020 – 2021

Përfundimi i projektit: Korrik 2021

Gjatë zhvillimit të punimeve konsumatorët do të informohen paraprakisht 24-48 orë përmes uebfaqes, rrjeteve sociale dhe aplikacionit eKesco.

